



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE



URDHRI I PSIKOLOGUT  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr. 3271 prot., datë 17.05.2018

Nr. 136 prot., datë 17.05.2018

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë (në vijim të quajtura "Palët")

*Duke vlerësuar rëndësinë e ushtrimit në mënyrë të ligjshme të profesionit të psikologut, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor në shërbim të popullatës;*

*Duke konsideruar si një ndër objektivat prioritarë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e profesionalizmit në ushtrimin e profesionit të psikologut në të gjithë vendin dhe zbatimin e angazhimeve reciproke për arritjen e këtij qëllimi;*

*Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandum;*

*Duke u mbështetur në kuadrin e plotë ligjor, që normon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: Ligjin Nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Ligjin Nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", etj;*

*Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim "Memorandumi")*

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i Memorandumit është bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve për rregullimin e mënyrës së ushtrimit të profesionit të psikologut, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe për kryerjen e praktikës profesionale, në përshatje me parimet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë.

## **Neni 2**

### **Forma e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:

- a. ndërmarrjes së iniciativave ligjore të përbashkëta për plotësimin e kuadrit ligjor që rregullon profesionin e psikologut;
- b. shkëmbimit të informacioneve reciproke në funksion të përmirësimit të cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse;
- c. ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta për amendimin e kuadrit ligjor, në të gjitha rastet kur konstatohet e nevojshme.

## **Neni 3**

### **Angazhimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes strukturave të saj, merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- a. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për plotësimin e kuadrit ligjor që mundësojnë fillimin e procedurave për kryerjen e praktikës profesionale dhe organizimin e provimit të shtetit për profesionin e psikologut, me qëllim licencimin e psikologëve të rinj;
- b. të ndërmarrë hapat e nevojshëm administrativ për fillimin e praktikës profesionale të praktikantëve psikologë në fushën e shëndetësisë;
- c. të asistojë, monitorojë dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për krijimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të edukimit në vazhdim për psikologët, me qëllim sigurimin e standardeve më të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit të psikologut.

## **Neni 4**

### **Angazhimet e Urdhrit të Psikologut**

Urdhri i Psikologut i Republikës së Shqipërisë, merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- a. të nisë procedurat për fillimin e kryerjes së praktikës profesionale dhe organizimin e provimit të shtetit për profesionin e psikologut, me qëllim licencimin e psikologëve të rinj, duke informuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjithë hapat e ndërmarrë;

- b. të ndërtojë, përditësojë dhe publikojë në faqen zyrtare regjistrin e praktikës, në të cilën të identifikojë statusin e çdo praktikanti;
- c. të informojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ecurinë e procesit të zhvillimit të praktikës profesionale nga ana e psikologëve;
- d. t'i propozojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale çdo nismë ligjore të nevojshme, që duhet të ndërmarrë kjo e fundit, me qëllim funksionimin e edukimit në vazhdim për profesionin e psikologut;
- e. të informojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për masat e marra gjatë proceseve disiplinore të zhvilluara për psikologët, që ushtrojnë veprimtari në strukturat vartëse të kësaj ministrie.

#### **Neni 5**

##### **Përfshirja nga praktika profesionale**

Bazuar në pikën 7, të nenit 11, të Ligjit Nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndyshuar, palët bien dakord që të përcaktojnë këto kritere për përfshirjen nga praktika profesionale, si më poshtë.

1. Përfshirëhet plotësisht nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, kandidati i cili provon se:
  - a) Ka ushtruar në mënyrë të rregullt profesionin si psikolog, për të paktën një vit para hyrjes në fuqi të Rregullores së Praktikës Profesionale.
2. Përfshirëhet pjesërisht nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, kandidati i cili provon se:
  - a) Ka ushtruar profesionin në mënyrë të rregullt si psikolog, për më pak se një vit para hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
  - b) Subjekti është i detyruar të vazhdojë praktikën deri sa, së bashku me kohën që i konsiderohet e përfshirë nga praktika sipas gërmes a) të kësaj pike, të plotësojë të paktën një vit praktikë.
3. Përfshirëhet plotësisht nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, kandidati i cili provon se, pas përfundimit të studimeve për marrjen e titullit psikolog, ka ushtruar profesionin përkatës apo ka kryer praktikën profesionale jashtë vendit, dhe është pajisur për këtë qëllim me një dokument zyrtar të lëshuar nga vendi ku ka ushtruar profesionin apo ka kryer praktikën.
4. Urdhri i Psikologut merr vendim individual për çdo rast të përfshirimit plotësisht apo pjesërisht nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale dhe informon për çdo rast Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

#### **Neni 6**

##### **Ndryshimi i Memorandumit**

Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 7  
Afati i Memorandumit

Ky memorandum lidhet për një afat 1(një) vjeçar. Palët mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

Neni 8  
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje e lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 9  
Hyrja në Fuqi

Memorandumi i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 2 (dy) të tjera pranë Urdhrit të Psikologut.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Znj. OGERTA MANASTIRLIU  
Ministër

URDHRI I PSIKOLOGUT  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Znj. VALBONA TRESKA  
President

sipas Autorizimit nr. 4490/2 prot., dt. 16.11.2017

Znj. Adriana JAKU  
Zv. Ministër

*Adriana Jaku*

